

## NË EMER TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretarën juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të akuzuarës S.S. nga ..., të cilën e mbron av. B.D. nga ..., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.128/18 të dt. 22.02.2018, të cilën e përfaqëson prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së seancës fillestare publike më dt. 26.02.2018, më dt. 10.05.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

### A K T G J Y K I M

E akuzuara S.S. nga babai H. dhe nëna N., e lindur R., e lindur më dt. ... në ..., jeton në ..., rr. “ ... ” nr...., e martuar, nënë e dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani e pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për veprën tjetër penale, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës

### Ë S H T Ë F A J T O R E

sepse më dt. 17.01.2018 rreth orës 11:15 minuta, në Gjilan, në rr. “ ... ” përballë gjellëtores “ ... ” e pandehura duke drejtuar automjetin e markës “ ... ” me tabela regjistrimit, numri i tabelave..., nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që duke mos i kryer detyrimet e shoferit për lëvizje me kujdes të shtuar për të ndërmarrë veprimin e anashkalimit në trafik, vetëm nëse më parë është bindur se nuk i rrezikon ose nuk i pengon pjesëmarrësit tjerë në trafik ose nuk e rrezikon pasurinë dhe të sigurohet se pas kryerjes së tejkalimit mjeti mund të kthehet në shiritin e trafikut nga i cili ka lëvizur më parë pa i penguar ose pa i rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në trafik, ku një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 41 paragr.1, me nenin 73 paragr.2 pika 2.2 të Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Rrugor të Kosovës, ashtu që përderisa ishte duke lëvizur nga udhëkryqi në drejtim të xhamisë së “ ... ” me të arritur përballë gjellëtores “ ... ” duke mos e përshtatë shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe fushëpamjes në rrugë, bën anashkalim të pasigurt dhe me krahun e parë të anës së djathtë të automjetit të saj e godet në mbrojtësin dhe anësoren e pasme të anës së majtë, ku pastaj ka pasur kontakti në të dy dyert dhe krahun e parë të automjetit “ ... ” të cilin po e ngiste e dëmtuara Sh.Sh., ku si pasojë e këtij aksidenti, përpos dëmeve materiale në automjet, lëndime të lehta trupore pëson vetë e pandehura dhe ngasësja e automjetit “ ... ”, sipas raporteve mjekësore të Spitalit Regjional të Gjilanit – Emergjencia me nr. ... dhe ... të dt. 17.01.2018 dhe ekspertizave mjekoligjore.

- me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragr.6 lidhur me paragr. 1 KPRK.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4,41,42,49,50,51,52, 73 dhe 74 KPRK si dhe nenit 248 dhe 365 KPPK të pandehurës i shqipton

### DËNIMIN ME KUSHT

*I. Të pandehurës i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 90(nëntëdhjetë) ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura brenda periudhës kohore prej 1(një) viti nuk kryen tjetër veprë penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.*

*II. E dëmtuara Sh.Sh. nga Gjilani, rr. e “ ... ” nr.... për realizimin e kërkesës pronëso-ro-juridike është udhëzuar në kontestin civil.*

*III. E pandehura obligohet që të paguaj ekspertizën ligjore të dt. 17.01.2018*

*IV. Obligohet e pandehura që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 25 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.*

### **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritë aktakuzën PP.I. nr. 128/2018 të dt. 22.02.20188, kundër të pandehurës S.S. nga ..., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 KPRK dhe i ka propozuar gjykatës që e pandehura të shpallet fajtores dhe të ndëshkohet sipas ligjit.*

*Prokurorja e Prokurorisë Themelore në Gjilan Leonora Shemsiu-Kadriu në seancën e caktuar lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal të mbajtur më dt. 10.05.2018, mbeti pranë marrëveshjes së arritur mbi pranimin e fajësisë të lidhur konform ligjit dhe dispozitave të nenit 233 KPPRK, me ç'rast e pandehura është njoftuar për pasojat dhe natyrën e nënshkrimit të pranimit të fajësisë dhe mbetet pranë qëndrimit se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që gjykata në tërësi të aprovoj marrëveshjen e përmendur.*

*Mbrojtësi i të akuzuarës në tërësi është pajtuar me propozimin e prokurores së shtetit që propozimi të aprovohet se gjatë arritjes së marrëveshjes e akuzuara është e vetëdijshme për pranimin e fajësisë, është pajtuar me këtë dhe garanton se në të ardhmen nuk do të ndeshet me ligjin sepse sinqerisht e ka pranuar fajësinë. E akuzuara pendohet për veprën e kryer, deri sot nuk ka qenë e gjykuar, andaj, lutë gjykatën që të ketë parasysh këtë fakt, sepse edhe me këtë dënim ka për tu arritur qëllimi i ndëshkimit.*

*Marrëveshja për pranimin e fajësisë i përmban të gjitha faktet, propozimin për arritje të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, njoftimin e të akuzuarës me të drejtat e saj dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhënia e deklaratës me shkrim, se e njëjti ka pranuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se të gjitha këto i ka pranuar me vullnetin e saj të lirë.*

*Gjykata gjen se e akuzuara ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal konform nenit 233 KPPRK dhe se e njëjta marrëveshje është në harmoni me kushtet e parapara me nenin pikën 12 të këtij neni.*

*Gjykata vërtetoi se e akuzuara ka kryer veprën penale dhe konstatoi se nuk ekziston asnjë rrethanë për përjashtim e paraparë me nenin 248 KPPRK.*

*Gjykata aprovoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë të lidhur në mes të PTH-Departamentit të Përgjithshëm nga njëra anë, të pandehurës dhe mbrojtësit të saj nga ana tjetër për kryerjen e veprës penale të cekur në aktakuzën PP.nr. 128/2018 të dt. 22.02.2018, pasi që për këtë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore.*

*Gjykatësja e vetme gjykuese vlerësoi se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e të pandehurës, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e saj, se e pandehura nuk ka qenë i detyruar në asnjë mënyrë të pranoj fajësinë. Pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet e cekura në aktakuzë dhe nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 253.paragr.1 KPPRK.*

*Gjykata është e bindur se shqiptimi i dënimit me gjobë është në harmoni me peshën e kryerjes së veprës penale dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41. KPRK.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është bazuar në nenin 451 KPPRK ndërsa vendimi mi kërkesën pronësoro juridike është marr në bazë të nenit 463 KPPRK.*

*Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
*P.nr.205/2018 më dt. 10.05.2018*

*Sekretarja juridike,*  
*Suzana Kovaçeviq, d.v.*

*Gjyqtarja e vetme gjykuese,*  
*Snezhana Mihajloviq, d.v.*

**UDHËZIMI JURIDIK:** *Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.*

**Përktheu –**  
*Naile Keçmezi*



